



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8-10/2022 regjistër (JR)
Datë 04.05.2026

Nr. 12/2 i vendimit
Datë 11.05.2026

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.05.2026, ditën e hënë, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, kërkesën që i përket:

KËRKUES: Arben Dosti.

OBJEKTI: Sqarim, interpretim i vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

BAZA LIGJORE: Neni 314 i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuarit Arben Dosti, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), në të cilën kërkoi sqarim, interpretim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Dosti, në datën 30.01.2026 është njohur me vendimin me arsyetim të plotë, me nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”). Sipas këtij vendimi trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 479, datë 03.12.2021, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

2. Në datën 19.02.2026, në Kolegj është regjistruar çështja me nr. 3-10/2022 (JR), datë 19.02.2026, mbi kërkesën¹ e kërkuarit Arben Dosti për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit.

Trupi gjykues, me vendimin nr. 12/1 (JR), datë 28.04.2026, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës nr. 3-10/2022 (JR), datë 19.02.2026 të kërkuarit Arben Dosti.

3. Në datën 04.05.2026, në Kolegj është regjistruar çështja nr. 8-10/2022 (JR), datë 04.05.2026, mbi kërkesën² e kërkuarit Arben Dosti (në vijim “kërkuari”), për sqarim dhe interpretim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit.

II. Kërkesa e kërkuarit Arben Dosti

4. Kërkuari është shprehur në kërkesën e tij, në mënyrë të përmbledhur, se pasi ka lexuar vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 dhe vendimin nr. 12/1 (JR), datë 28.04.2026 të Kolegjit, ka konstatuar se nuk ka asnjë sqarim, interpretim apo çfarëdo analize se cilën pjesë të pasurisë së deklaruar prej tij, Kolegji ka njohur si të ligjshme dhe cilën si të paligjshme. Sipas kërkuarit, në arsyetimin e vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, (në paragrafët 22.3, 25.2, 27.2), nga e gjithë pasuria e deklaruar prej tij dhe nënës së tij, Kolegji ka njohur vetëm shumën 3.900.000 lekë, shumë e cila ndodhet e gjitha në llogarinë e nënës së tij dhe vetëm një pjesë e shumës që ajo disponon në llogarinë e saj, që prej vitit 2006, ndërkohë që në vijim të arsyetimit i njeh si të provuar me dokumenta të ligjshme, shumën 10.246.150 lekë. Në këto kushte, kërkuari i kërkon Kolegjit të sqarojë dhe interpretojë se çfarë të ardhurash të deklaruara prej tij përfshin shuma prej 10.246.150 lekësh, e njohur si e ligjshme prej Kolegjit.

¹ Kërkesë e regjistruar në protokollin e Kolegjit, me nr. {***} prot., datë 19.02.2026.

² Kërkesë e regjistruar në protokollin e Kolegjit, me nr. {***} prot., datë 04.05.2026.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenet 65 dhe 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si dhe nenet 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e kërkesave për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimeve të dhëna prej tij, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Për rrjedhojë, kërkesa në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt sqarimin dhe interpretimin e një vendimi të Kolegjit, i cili ka vendosur përfundimisht për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të kërkesës

7. Shqyrtimi i kërkesës së kërkuesit për sqarim dhe interpretim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit u krye nga trupi gjykues, fillimisht, në dhomë këshillimi, në zbatim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.
8. Trupi gjykues vlerësoi se objekti i kërkesës së paraqitur nga kërkuesi bie në rregullimin e parashikuar nga neni 314 i Kodit të Procedurës Civile, i cili legjitimon gjykatën që të sqarojë dhe interpretojë vendimin që ajo ka dhënë. Zbatimin e nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile e dikton parashikimi i nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, dispozita të cilat orientojnë Kolegjin në aplikimin e normave të Kodit të Procedurës Civile, në rast se situatat ligjore të prezantuara për zgjidhje nuk gjejnë një zgjidhje të posaçme nga vetë ligji nr. 84/2016.

Në përputhje me përmbajtjen e dispozitave të sipërcituara, kërkesa e kërkuesit u shqyrtua nga i njëjti trup gjykues i Kolegjit që ka dhënë vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 dhe vendimin nr. 12/1 (JR), datë 04.05.2026.

Kërkesa me nr. {***} prot., datë 04.05.2026, e kërkuesit Arben Dosti, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 06.05.2024, iu komunikua Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Trupi gjykues vëren se neni 314, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, nuk parashikon thirrjen e palëve në shqyrtimin e kërkesës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit. Në kuptim të këtij parashikimi, trupi gjykues vijoi me vazhdimin e gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentacionit të fashikullit të çështjes.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me kërkesën për sqarim dhe interpretim vendimi

9. Trupi gjykues, lidhur me pretendimin³ e kërkuesit për sqarim dhe interpretim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, analizoi si vijon.

³ Sipas përmbajtjes së kërkesës së paraqitur në Kolegj nga kërkuesi Arben Dosti, regjistruar me nr. {***} prot., datë 04.05.2026.

10. Duke mbajtur në konsideratë që i njëjti kërkues i është drejtuar për herë të dytë Kolegjit për sqarimin dhe interpretimin e të njëjtit vendim të Kolegjit (për të cilën është shprehur një herë Kolegji me vendimin nr. 12/1 (JR), datë 28.04.2026), trupi gjykues vlerëson të verifikojë, paraprakisht, nëse pretendimet e ngritura i janë nënshtruar më parë kontrollit prej tij.
11. Trupi gjykues vëren se në rastin e parë që kërkuesi ka vënë në lëvizje Kolegjin, me vendimin nr. 12/1 (JR), datë 28.04.2026, është vendosur rrëzimi i kërkesës, pasi trupi gjykues në atë rast ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit ishin të pabazuara. Në gjykimin e parë, kërkesa është paraqitur personalisht nga kërkuesi dhe ka pasur si objekt: (i) *plotësimin e vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit;* (ii) *sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit.*
Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit është kërkuar sërish nga kërkuesi edhe në kërkesën e dytë objekt shqyrtimi.
12. Në kërkesën e parë, e cila është gjykuar në Kolegji dhe për të cilën trupi gjykues ka marrë vendimin nr. 12/1 (JR), datë 28.04.2026, kërkuesi, ndër të tjera, në paragrafët 29.1. dhe 29.2 të saj, ka ngritur pretendimin:
*“29.1 Nuk rezulton që të ketë asnjë analizë nga Kolegji, se cilat pasuri të deklaruara prej meje konsiderohen të ligjshme dhe në vlerën 10.246.150 lekë dhe përse pjesa tjetër sipas llogaritjes rreth 20.000.000 lekë konsiderohet e paligjshme, Konstatohet se Kolegji është shprehur se nuk provohet ekzistenca e të ardhurave nga emigrimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë “{***}”. Kolegji pranon vetëm ekzistencën e të ardhurës 3.900.000 lekë nga shitja e lokalit, por që kjo shumë është 65% e shumës që nëna ime ka në llogarinë e saj që prej vitit 2006, ndërkohë që në kohën e paraqitjes së dekaratës vetting, nëna ime ka patur në llogari shumën 4.000.000 lekë.*
29.2 Në këto kushte, i kërkoj Kolegjit sqarim dhe interpretim vendimi si vijon:
1. Të sqarojë dhe interpretojë se shuma 10.246.150 lekë e deklaruar prej Kolegjit si e provuar me të ardhura të ligjshme, çfarë të ardhurash të deklaruara prej meje përfshin, si dhe cilat janë provat që provojnë ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume?
2. Të tregojë se cilat janë të ardhurat personale të miat, të përfshira në shumën 10.246.150 lekë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të tyre?”
13. Në kërkesën e dytë, objekt i këtij gjykimi, kërkuesi, në paragrafët 5 dhe 6 të saj, ka ngritur pretendimin se:
“5. Kolegji, në arsyetimin e vendimit (paragrafët 22.3, 25.2. 27.2), nga e gjithë pasuria e deklaruar prej meje dhe nëna ime, ka njohur vetëm shumën 3.900.000 lekë, shumë e cila ndodhet e gjitha në llogarinë e nënës sime dhe është vetëm një pjesë e shumës që ajo disponon në llogarinë e saj, që prej vitit 2006. Ndërkohë, në vijim të arsyetimit më njeh si të provuar me dokumenta të ligjshme, shumën 10.246.150 lekë.
6. Në këto kushte i kërkoj Kolegjit, sqarim dhe interpretim vendimi si vijon:
1. Të sqarojë dhe interpretojë se shuma 10.246.150 lekë e njohur si e ligjshme prej Kolegjit, çfarë të ardhurash të deklaruara prej meje përfshin?”

14. Për sa më sipër, pretendimet e kërkuarit lidhur me sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, trupi gjykues i ka pasur objekt shqyrtimi në vendimmarrjen e tij të mëparshme për të njëjtat shkaqe, për rrjedhojë ato duket se në analogji përbëjnë “gjë të gjykuar”.
15. Bazuar në konkluzionin si më sipër arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se çështja nr. 8-10/2022 (JR), datë 04.05.2026, mbi kërkesën e kërkuarit Arben Dosti për sqarim dhe interpretim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në pikën 6, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës nr. 8-10/2022 (JR), datë 04.05.2026, të kërkuarit Arben Dosti.
2. Të njoftohet kërkuari me këtë vendimmarrje.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 11.05.2026.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi